

**MBI**  
**AUDITIMIN E USHTRUAR NË**  
**BASHKINË PËRMET**

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në Bashkinë Tiranë, Njësia Administrative Vaqarr dhe Pezë, me objekt: *“Mbi zbatimin e procedurave të dhënies me qira dhe shitjes së tokave në pronësi të shtetit, të llojit tokë pa fryt, në brigje lumenjsh dhe baseneve ujore etj” dhe “Për vlerësimin e sigurimit të cilësisë së auditimit në të nxehtë të auditimit të mëparshëm”, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2011 deri më 31.12.2015 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 33, datë 31.03.2016*

Bazuar në nenet mbështetje të neneve 10, 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *“Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 703/32 datë 04.04.2016, i ka rekomanduar z. Erion Veliaj, Kryetar i Bashkisë Tiranë, zbatimin e masave të mëposhtme:*

## **A. MASA ORGANIZATIVE**

**1. Gjetjet nga auditimi:** Ish-Komuna Vaqarr, lidhur me Kontratën e qirasë nr. 1743, datë 01.12.2011 dhe Kontratës së shitjes nr. 2574 rep. dhe 775 kol. datë 15.07.2015, me shoqërinë “A...R” Shpk, ka dhënë një sipërfaqe toke e cila nuk është pjesë e fondit pyjor e kullësor, por tokës bujqësore, si dhe qëllimi i përdorimit nuk është sipas kriterëve të përcaktuara në ligjin nr. 9385, datë 04.05.2005 dhe VKM nr. 391, datë 21.03.2006, pasi nga subjekti privat nuk është kërkuar marrja e tokës, për aktivitete të lejuara nga ligji, por për ndërtim dhe prodhim nyje betoni. Në kontratën e shitjes nuk ka pasqyruar faktin se mbi pasurinë objekt transaksioni, subjekti “A...R”, ka ngritur ndërtim pa leje, fakti i dokumentuar nga Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Kombëtar, më datë 27.08.2012, procesverbali seria nr. 008940 dhe vendimi nr. 21, datë 03.09.2012.

**1.1 Rekomandimi:** Bashkia Tiranë, në bashkëpunim me Njësinë Administrative Ish-Komuna Vaqarr dhe Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit, në zbatim të ligjit nr. 183/2014, datë 24.12.2014 *“Për Inspektimin e Ndërtimit”, të marrë masat për eliminimin e pasojave të krijuara nga ngritja e ndërtimit të paligjshëm të kryera nga subjekti privat “A...R” Shpk, si dhe kthimin e situatës në gjendjen e mëparshme, duke kryer lirimin dhe pastrimin e territorit.*

**Menjëherë**

**2. Gjetjet nga auditimi:** Ish-Komuna Vaqarr, lidhur me Kontratën e qirasë nr. 1365, datë 27.08.2014 dhe Kontratës së shitjes nr. 4282 rep. dhe 754 kol. datë 13.07.2015, me shoqërinë “A...M” Shpk, ka dhënë me qira një sipërfaqe toke e cila nuk është pjesë e fondit pyjor e kullësor, por tokës bujqësore, si dhe qëllimi i përdorimit nuk është sipas kriterëve të përcaktuara në ligjin nr. 9385, datë 04.05.2005 dhe VKM nr. 391, datë 21.03.2006, pasi nga subjekti privat nuk është kërkuar marrja e tokës, për aktivitete të lejuara nga ligji, por për ndërtim stallash për rritje derrash, përpunim mish e nënprodukteve të tij. Në kontratën e shitjes nuk ka pasqyruar faktin se mbi pasurinë objekt transaksioni, subjekti “A...M”, ka ngritur ndërtim, sipas lejes zhvillimore nr. 01/2, datë 27.02.2015, *“Kapanon 1 kat për linjë*

*prodhimi të ushqimit për kafshë*”, me sipërfaqe truall që zhvillohet 20500 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe e truallit që zë struktura (gjurma) 976 m<sup>2</sup> dhe kontrata e shitblerjes është lidhur për pasurinë, e llojit tokë pa fryt dhe jo truall.

**2.1 Rekomandimi:** Bashkia Tiranë, në bashkëpunim me Njësinë Administrative Ish-Komuna Vaqarr, të marrë masat për eliminimin e pasojave të krijuara nga ngritja e ndërtimit të paligjshëm të kryera nga subjekti privat “A...M” Shpk, si dhe kthimin e situatës në gjendjen e mëparshme.

**Brenda datës 30.06.2016**

**3. Gjetjet nga auditimi:** Ish-Komuna Vaqarr, lidhur me Kontratën e qirasë nr. 1743, datë 01.12.2011 dhe Kontratës së shitjes nr. 2574 rep. dhe 775 kol. datë 15.07.2015, me shoqërinë “A...R” Shpk, nuk ka pasqyruar faktin se toka nuk ka qenë e lirë në momentin e dhënies me qira dhe shitjes, pasi realizimi i ndërtimit mbi pasurinë prej 10000 m<sup>2</sup> e ka tjetërsuar në tokë truall, (tokë e pajisur me infrastrukturë dhe ndërtime) kur kontratat janë për pasurinë e regjistruar në pasurinë nr. 1/13, volum 5, faqe 31, zk. 3784, e llojit tokë pa fryt, tokë e lirë dhe pa ndërtime.

Çmimi i shitjes të tokës i është referuar vlerës minimale të tatueshme nga shtetit, për tokat pyjore, e cila sipas VKM nr. 514, datë 30.07.2014 është në vlerën prej 85 lekë/m<sup>2</sup>, kur toka nuk vjen nga fondi i tokës pyjore, por bujqësore, dhe referenca e çmimit minimal të tatueshëm është 230 lekë/m<sup>2</sup>, duke sjellë për pasojë vlerë tjetër të kontratës dhe konkretisht çmimi duhet të ishte 230 lekë/m<sup>2</sup> x 10000 m<sup>2</sup> = 2,300,000 lekë dhe jo 850,000 lekë, me një diferencë prej 1,450,000 lekë.

Nga mos llogaritja e çmimit të shitjes në bazë të VKM nr. 514, datë 30.07.2014 “*Për miratimin e vlerës së pronës për secilin qark*”, ku çmimi minimal i tokës truall është 395 lekë/m<sup>2</sup>, por duke kryer transaksionin me çmimin 85 lekë/m<sup>2</sup>, ka sjellë për pasojë një efekt financiar të ndryshëm nga ai i përcaktuar, ku çmimi minimal i shitjes duhet të ishte jo më pak se 3,950,000 lekë.

Nuk janë ndryshuar kushtet e kontratës së qirasë, sipas VKM nr. 54, datë 05.02.2014, “*Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore*”, dhe konkretisht kreu III/2 “*Kur jepet me qira truall i lirë, pra kur jepet me qira ose enfiteozë vetëm truall, tarifa dysHEME e qirasë mujore është 100 lekë/m<sup>2</sup>*”, hap që do të sillte për të ardhura financiare me vlera shumë më të konsiderueshme se ato të përfituara nga data 01.12.2011 deri më datë 15.07.2015 (*Trajtuar në faqet 7-16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**3.1 Rekomandimi:** Bashkia Tiranë, në bashkëpunim me Njësinë Administrative Ish-Komuna Vaqarr, lidhur me kontratën nr. 2574 rep. dhe 775 kol. datë 15.07.2015, me shoqërinë “A...R” Shpk, të marrë në vlerësim e shqyrtim materialin e Auditimit, të analizojnë të gjitha shkeljet dhe parregullsitë e konstatuara, të vlerësojnë shkeljet me pasojë dëm ekonomik, si dhe fillojnë të gjitha procedurat e duhura ligjore e administrative për eliminimin e pasojave dhe kthimin e situatës në gjendjen e mëparshme, deri në prishjen/anulimin e kontratës.

**Menjëherë**

**4. Gjetjet nga auditimi:** Nga ish-Komuna Pezë pa marrë në vlerësim referencat ligjore në fuqi, dhe pa asnjë lloj procedure konkurrimi dhe publikimi, ka kryer shitjen në favor të 3

(tre) subjekteve private të sipërfaqes së tokës të fondit bujqësor, Tokë Inproduktive (Pa Fryt), prej 60881 m<sup>2</sup>; Përdorimi i fondeve pas realizimit të kontratës së shitjes nuk rezulton të jetë përdorur sipas qëllimit për të cilin është kërkuar shitja e pronës; Për pasurinë regjistruar me nr. 240/4, volum 8 faqe 189, me sipërfaqe 11916 m<sup>2</sup>, dhe pasurinë nr. 240/5, volum 8 faqe 190, me sipërfaqe prej 3500 m<sup>2</sup>, ndodhur në zonën kadastrale 2953, në dosjet respektive mungon apo nuk është kryer raport vlerësimi pasurie, duke munguar përcaktimi i vlerës së tokës sipas VKM nr. 514, datë 30.07.2014, dhe referencave të tregut të lirë; Për secilën pasuri (pjesë e të njëjtës parcela me nr. 240), nuk është marrë parasysh fakti se prona nuk është tokë bujqësore (e frytshme apo jo) por breg lumi Erzen; Nuk ka kërkesë drejtuar Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit lidhur me ndryshimin e zërit kadastral të fondit, dhe nëse parcela 240, pjesë e bregut të lumit Erzen, është pjesë e fondit të regjistruar “Zall” dhe pjesë e zonës së mbrojtur si pjesë e argjinaturave të lumit, si dhe nëse mbi këtë parcelë mund të veprohet me qëllim investimi apo tjetërsimi prone; Ish-Komuna Pezë me miratimin e tjetërsimit e pronës ka vepruar dhe në kundërshtim me qëllimin e përdorimit të saj, të miratuar nga KM, sipas Vendimit nr. 17, datë 04.07.2013 të Këshillit Kombëtar të Territorit, “Për miratimin e instrumenteve të përgjithshme vendore, Komuna Pezë”, pasi parcela 240 nuk është përfshirë e tëra në studim dhe për pjesën të cilën është brenda tij është përcaktuar si zonë që shërben për qëllime bujqësore dhe sera.

**4.1 Rekomandimi:** Bashkia Tiranë dhe Njësia Administrative ish-Komuna Pezë, të marrë në vlerësim e shqyrtim Raportin Përfundimtar të Auditimit Tematik, të analizojë shkeljet dhe parregullsitë e konstatuara, si dhe të iniciojë të gjitha procedurat e duhura ligjore e administrative për eliminimin e pasojave të krijuara, duke synuar kthimin e situatës në gjendjen e mëparshme.

## **Menjëherë**

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga Ish-Komuna Vaqarr dhe Pezë, janë lidhur 5 kontrata shitje pasurie pronë shtetërore dhe 1 kontratë dhënien me qira, të llojit tokë bujqësore “pa frutë” apo “truall”, veprime në kundërshtim me: VKM nr. 388, datë 25.05.2011 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Vaqarr” dhe VKM nr. 478, datë 30.05.2013 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Pezë”, pasi edhe pse rezulton se pasuritë janë në pronësi të NJQV, qëllimi/fusha e përdorimit është “Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka jo produktive) dhe kanale të treta”, apo “Infrastrukturë (rrugë vendore, sheshe dhe shërbime publike)”, tjetërsim në kundërshtim me qëllimin e përdorimit të miratuar nga Këshilli i Ministrave; VKM nr. 428, datë 09.06.2010 “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet apo transformohet dhe për procedurën e shitjes” dhe Udhëzimi nr. 1, datë 22.11.2010; nenit 7, 10, 35, 72 dhe 73 të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”; nenit 8, 9, 11 dhe 12 të ligjit nr. 8744, datë 21.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”; nenit 1, 3, 37, 43, 44, 49 dhe 55 të ligjit nr. 8093, datë 21.03.1996 “Për rezervat ujore” nenit 2, 11, 12 dhe 13 të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001 “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”; nenit 1 dhe 3 të ligjit nr. 8337, datë 30.4.1998 “Për kalimin në pronësi të tokës bujqësore, pyjore, livadheve dhe kullotave”; VKM nr. 514, datë

30.07.2014 “Për miratimin e vlerës së pronës për secilin qark në RSH”; VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitëozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”; VKM nr. 460, datë 22.5.2013 “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe procedurave të dhënies me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit” (Trajtuar në faqet 45-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit të Ish-Komuna Vaqarr dhe 7-15 e 17-27 të ish-Komuna Pezë).

**5.1 Rekomandim:** Bashkia Tiranë, në bashkëpunim me Njësinë Administrative Ish-Komuna Vaqarr dhe Pezë, ti kërkohet Regjistruarit të ZVRPP Tiranë të marrë masa, që në bazë të nenit 5.1, nenit 49.1 dhe nenit 59, të ligjit nr. 33/2012, datë 21.03.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor të përcjellë zyrtarisht nga ZVRPP Tiranë, në cilësinë e pronarit të ligjshëm të pasurive, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë:

Zona kadastrale 3784, Vishaj, pasuria nr. 1/13, vol. 5 faqe 31, “tokë pa frutë”, me sipërfaqe prej 10000 m<sup>2</sup>, regjistruar në emër të subjektit “A...R” Shpk.

Zona kadastrale 3784, Vishaj, pasuria nr. 1/9, vol. 4 faqe 186, “tokë pa frutë”, me sipërfaqe prej 20500 m<sup>2</sup>, regjistruar në emër të subjektit “A...M” Shpk.

Zona kadastrale 3712, Fortuzaj, pasuria nr. 180/1, vol. 12 faqe 147, “tokë pa frutë”, me sipërfaqe prej 36850 m<sup>2</sup>, dhe pasuria nr. 172/3, vol. 12 faqe 146, “tokë pa frutë”, me sipërfaqe prej 9375 m<sup>2</sup>, në emër të Komuna Vaqarr dhe regjistruar kontratë qiraje në favor të “A.E.F” Shpk.

Zona kadastrale 2953, Pezë Helmëz, pasuria nr. 240/4, vol. 8 faqe 189, “tokë pa frutë”, me sipërfaqe prej 11916 m<sup>2</sup>, regjistruar në emër të subjektit “B.Ç.”.

Zona kadastrale 2953, Pezë Helmëz, pasuria nr. 240/5, vol. 8 faqe 190, “tokë pa frutë”, me sipërfaqe prej 3500 m<sup>2</sup>, regjistruar në emër të subjektit “P.Ç.”.

Zona kadastrale 2953, Pezë Helmëz, pasuria nr. 240/1, vol. 8 faqe 144, “tokë pa frutë”, me sipërfaqe prej 45465 m<sup>2</sup>, regjistruar në emër të subjektit “E.C.”.

**Menjëherë**

## **B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

Mbështetur në ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”, pjesa e VI, Kreu I, nenet 105-109 dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave, nr 30, datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Kap IV, Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, pika 93, nga ana e titullarit të njësisë publike (Nëpunësit Autorizues), të nxirren aktet administrative dhe (Nëpunësi zbatues), të kryejë kontabilizimet duke ndjekur të gjitha procedurat ligjore, administrative dhe përmbareme me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, në vlerën totale prej **7,311,360 lekë**, si më poshtë:

**1. Gjetjet nga auditimi:** Ish-Komuna Vaqarr, lidhur me Kontratën e qirasë nr. 1365, datë 27.08.2014 dhe Kontratës së shitjes nr. 4282 rep. dhe 754 kol. datë 13.07.2015, me shoqërinë “A.F.” Shpk, nuk ka pasqyruar faktin se mbi pasurinë objekt transaksioni, subjekti ka ngritur ndërtim me leje, sipas lejes zhvillimore nr. 01/2, datë 27.02.2015, “Kapanon 1 kat për linjë prodhimi të ushqimit për kafshë”, me sipërfaqe trualli që

zhvillohet 20500 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe e truallit që zë struktura (gjurma) 976 m<sup>2</sup> dhe kontrata e shitblerjes është lidhur për pasurinë, e llojit tokë pa fryt.

Mos ndryshimi i destinacionit të tokës, në truall, ka sjellë për pasojë mos llogaritje çmimi shitje në bazë të VKM nr. 514, datë 30.07.2014, “Për miratimin e vlerës së pronës për secilin qark”, ku dhe është përcaktuar se çmimi minimal është 395 lekë/m<sup>2</sup>, (976 m<sup>2</sup> x 395 lekë/m<sup>2</sup>=385,520 lekë dhe jo 82,960 lekë, ose më shumë 302,560 lekë), shumë e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e NJQV.

Nuk është bërë referimi në VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, për sipërfaqen tokë tjetërsuar në truall sipas lejes zhvillimore nr. 01/2, datë 27.02.2015, ku sipas VKM nr. 54, datë 05.02.2014, Kreu III, pika 2 “Kur jepet me qira truall i lirë, tarifa dysHEME e qirasë mujore është 100 lekë/m<sup>2</sup>”. Mos ndryshimi i kushteve të kontratës së qirasë dhe tarifës për pjesën e tokës të tjetërsuar në truall, ka sjellë si rezultat dëm ekonomik shkaktuar buxhetit të shtetit në vlerën prej 97,600 lekë/muaj (976 m<sup>2</sup> x 100 lekë/m<sup>2</sup>), ose për 5 muaj, 488,000 lekë.

**1.1 Rekomandimi:** Bashkia Tiranë, në bashkëpunim me Njësinë Administrative Ish-Komuna Vaqarr, të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i shumës prej **790,560 lekë** nga të cilat shuma prej 302,560 lekë, shkaktuar nga mos aplikimi i drejtë i çmimit të tokës në kontratën e shitjes nr. 4282 rep. dhe 754 kol. datë 13.07.2015, dhe shumës prej 488,000 lekë, shkaktuar nga mos aplikimi i drejtë i çmimit të tokës në kontratën e qirasë nr. 1365, datë 27.08.2014, për pasurinë e ndodhur në zonën kadastrale 3784, pasuria nr. 1/9 me sipërfaqe prej 20500 m<sup>2</sup>.

**Brenda datës 30.06.2016**

**2. Gjetjet nga auditimi:** Ish-Komuna Vaqarr, lidhur me Kontratën e qirasë nr. s’ka, datë 28.01.2013, me shoqërinë “A.E.F.” Shpk, nuk ka pasqyruar faktin se mbi pasurinë objekt transaksioni, subjekti ka ngritur ndërtim me leje, sipas lejes zhvillimore nr. 08/8, datë 16.10.2013, “Kapanon metalik 1 kat me elementë të çmontueshëm”, me sipërfaqe truall që zhvillohet 46225 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe e truallit që zë struktura (gjurma) 2508 m<sup>2</sup>.

Mos ndryshimi i destinacionit të tokës, në truall, ka sjellë për pasojë mos referim në VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, për sipërfaqen tokë tjetërsuar në truall sipas lejes zhvillimore nr. 08/8, datë 16.10.2013, ku sipas VKM nr. 54, datë 05.02.2014, Kreu III, pika 2 “Kur jepet me qira truall i lirë, tarifa dysHEME e qirasë mujore është 100 lekë/m<sup>2</sup>”. Mos ndryshimi i kushteve të kontratës së qirasë dhe tarifës për pjesën e tokës të tjetërsuar në truall, ka sjellë si rezultat dëm ekonomik shkaktuar buxhetit të shtetit në vlerën prej 250,800 lekë/muaj (2508 m<sup>2</sup> x 100 lekë/m<sup>2</sup>), për 26 muaj, 6,520,800 lekë. (Trajtuar në faqet 30-36 dhe 53-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**2.1 Rekomandimi:** Bashkia Tiranë, në bashkëpunim me Njësinë Administrative Ish-Komuna Vaqarr, të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i shumës prej **6,520,800 lekë**, shkaktuar nga mos aplikimi i drejtë i çmimit të tokës në kontratën e qirasë nr. ka, datë 28.01.2013, për pasurinë e ndodhur në zk. 3712, pasuria nr. 172/3 me sipërfaqe prej 9375 m<sup>2</sup> dhe pasuria nr. 180/1 me sipërfaqe prej 36850 m<sup>2</sup>.

**Brenda datës 30.06.2016**

## C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenet 58, germa a, b, c, ç, “Llojet e masave disiplinore” dhe 59 “Kompetencat dhe procedurat për masat disiplinore” të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, dhe ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i rekomandojmë Kryetarit të Njesisë të Qeverisjes Vendore, Bashkia Tiranë: Të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për mangësitë dhe shkeljet e trajtuara për secilin punonjës në Raportin Përfundimtar të Auditimit për ish-Komuna Vaqarr dhe të filloi procedurat për dhënien e masave disiplinore “Vërejtje” deri në “Largim nga Shërbimi Civil” për:

1. z. **G.M**, me detyrë Administrator i Njesisë Administrative Ish-Komuna Vaqarr dhe
2. z. **F.P**, me detyrë Jurist dhe Anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, pasi:

Në dhënien me qira të tokave, nuk kanë marrë parasysh, qëllimin e përdorimit të tyre, sipas VKM nr. 388, datë 25.05.2011 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Vaqarr”, si dhe që toka nuk është pjesë e fondit pyjor e kullosor, por pjesë e fondit të tokës bujqësore, duke sjellë për pasojë dhënien me qira të tyre me referencë të gabuar ligjore dhe konkretisht ligjin nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” dhe VKM nr. 391, datë 21.03.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”.

Qëllimi i përdorimit apo marrjes me qira të tokës, nga subjektet privatë është në kundërshtim me qëllimin e përdorimit që lejon ligji nr. 9385, datë 04.05.2005 dhe VKM nr. 391, datë 21.03.2006, pasi nga subjektet nuk është kërkuar marrja e ekonomisë pyjore, për aktivitete të lejuara nga ligji, por për ndërtim stallash, përpunim mish, prodhim nyje betoni, apo kultivim bimësh, nëpërmjet ndërtimit të volumeve ndërtimore.

Pa marrë në vlerësim referencat ligjore në fuqi, kanë kryer tjetërsimin e pronës shtetërore, nëpërmjet procedurave të shitblerjes, për llogari të subjekteve private, të sipërfaqes së pronës të llojit Tokë Inproduktive (PF) me sipërfaqe totale prej 30050 m<sup>2</sup>.

Zbatimi i procedurave është kryer duke marrë për bazë se fondi i tokës së shitur është Tokë Inproduktive Pyjore, kur në fakt sipas dokumentacionit toka është i llojit Tokë Bujqësore, Inproduktive (Tokë pa fryt). Përllogaritja e tokës si pjesë të fondit pyjor ka sjellë mos aplikimi të saktë të çmimit minimal të tatueshëm, me diferencë prej 4,422,500, ndërmjet çmimit të shitjes sipas kontratave dhe atij aktual minimal të tatueshëm (nëse ligji do të lejonte shitjen e tokës nga NJQV).

Nuk kanë marrë në konsideratë faktin se mbi trojet e dhëna me kontrata shitje, nga NJQV po të njëjtëve subjekte (në dy raste) kanë pasur të lidhura kontrata qiraje, dhe realizuar ndërtime, duke sjellë për pasojë që çmimi i shitjes për sipërfaqet nën objekt të mos përllogaritet si tokë truall, por tokë inproduktive, me pasojë përdorimin e referencave të gabuara, përse i përket çmimit të shitjes, ku çmimi sipas kontratave të shitjes është në vlerën prej 85 lekë/m<sup>2</sup> dhe çmimi minimal i tokës truall është në vlerën prej 395 lekë/m<sup>2</sup>.

Nga mos vlerësimi i pjesës së sipërfaqes të dhënë me qira, në favor të “A.F.” Shpk, “A.S.” Shpk dhe “A.E.F.” Shpk, të tjetërsuar në truall, me ndërtime me leje apo dhe pa leje (A.S.),

kanë krijuar dëm ekonomik në vlerën prej 7,008,800 lekë (llogaritur deri më datë 31.12.2015), si rezultat i mos aplikimit të tarifës prej 100 lekë/m<sup>2</sup> për sipërfaqet e llojit truall.

## **E. VLERËSIMI I ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE**

KLSH do të ndjek me vëmendje të veçantë dhe vlerësojë dhe marrjen e masave, që do të marrë Bashkia Tiranë për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga auditimi i kryer, reflektimin e tyre në përmirësimin e proceseve të veprimtarisë ekonomiko financiare, me qëllim mirë përdorimin e fondeve publike, në përputhje me parimet e ekonomicitetit, efikasitetit dhe efektivitetit në shërbim të komunitetit.

Në përfundim të afateve të përcaktuara në rekomandimet e dërguara dhe afatin e caktuar 6 muaj, në nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, do të kryejmë auditim të veçantë, për ecurinë dhe nivelin e zbatimit të masave të rekomanduara.

Nga Bashkia Tiranë, nuk është kthyer përgjigje akoma, së bashku me planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH, pasi nuk është ezauruar afati ligjor prej 20 ditë, pra rezulton se rekomandimet janë në proces vlerësimi.

**Shënim:** Auditimi është kryer nga audituesit shtetëror Ryisim Xhaja dhe Besmir Pajaj, më tej u shqyrtua nga z. Niko Nako kryeauditues, z. Xhaferr Xhoxhaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës.

## **KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**